

Vitamina për shëndetin e gjirit

Përgatitur nga Franz Riegler, Konsulent i Schaumann dhe

Aksioneri i AUSTRIA Prämix shpk



Inflamacioni i gjirit luan rol kryesor në vdekshmërinë e lopëve të qumështit. Kjo shkakton humbje të mëdha ekonomike. Rreth një në dy lopë sëmuret një herë gjatë laktacionit me mastit. Kjo rezulton në kosto mes 250 dhe 500 euro për lopë. Të ushqyerit ka si synim të reduktojë ndjeshëm rrezikshmërinë e lopës ndaj patogjenëve të inflamacionit të gjirit.

Inflamacioni i gjirit te lopët e qumështit është i varur nga disa faktorë. Klima e stallës duhet të jetë e përshtatshme dhe shtretërit duhet të jenë jo vetëm të rehatshëm, por edhe të pastër me qëllim që mos të përçohen infeksione nga njëra kafshë te tjetra. Nëse kemi të bëjmë me inflamacion të gjirit ndikojnë gjithashtu edhe teknikat e mjeljes si dhe mjelja. Me mënyrën e të ushqyerit, fermeri ka çelsat në dorë për t'i bërë lopët gati për laktacionin e rradhës në mënyre që ato të jenë rezistente ndaj patogjenëve që shkaktojnë inflamacionin e gjirit. Një patogjen është i aftë të shkaktojë infektimin e gjirit vetëm nëse ndikohet edhe nga faktorë të tjerë të favorshëm.

Përmes mungesave në të ushqyer, lopët me sistem imunitar të ulët janë më të predispozuara të kenë inflamacione të gjirit. Dhjamosja e lopëve të vjetra dhe atyre në tharje, luan një rol kyç në të qënurit më të ndjeshëm ndaj inflamacionit, por edhe mungesa e theksuar e energjisë në laktacion dhe furnizimi i pamjaftueshëm me vitamina, minerale dhe mikroelementë mund të kenë një efekt negativ.

Të ushqyerit e duhur para dhe pas pjelljes

Një vëmendje e veçantë i duhet dhënë të ushqyerit përgjatë periudhës së pjelljes. Pjesa më e madhe e infeksioneve vijnë nga periudha e laktacionit. Kjo, sepse në atë periudhë organizmi i lopëve është i ekspozuar dhe sistemi imunitar është më i dobët. Me anë të kequshqyerjes me pamjaftueshmërinë e



ushqimeve voluminoze ose me një strukturë të gabuar të racioneve me vlera ushqimore vijnë si pasojë sëmundje të pashmangshme metabolike dhe mastit. Por, pse disa lopë sëmuren dhe disa te tjera jo, edhe pse janë të ushqyera nga të njëjtat racione? Shkencëtarët e universitetit të Illinoisit (SHBA) iu përgjigjen kësaj pyetjeve në një kërkim të realizuar duke patur nën vëzhgim 15 lopë Holstein dhe 15 lopë Jersey nga periudha e tharjes deri në javën e tetë të laktacionit. Ata ekzaminuan përqëndrimin e proteinave dhe vitaminave të plazmës në gjak. Për ta kuptuar këtë ata përdorën sistemin BCS (Indeksi trupor) peshën trupore të lopës ose humbjet në peshë.

Nga kërkimet shkencëtarët mundën të demonstrojnë në përpjekjen e tyre se lopët, të cilat para pjelljes kishin një indeks dhe një peshë trupore më të lartë, pas pjelljes ato humbën më shumë peshë dhe janë më të predispozura ose të diagnostifikuara me mastit subklinik. Lopët me indekse të larta trupore, të cilat kanë një mobilizim të lartë të yndyrës para dhe pas pjelljes, janë më të prirura për infeksione të mastitit. Duke iu referuar përmbajtjes të proteinave dhe laktozës si edhe përmbajtjes të uresë në qumësht, kjo e fundit është e ulët te lopët e sëmura dhe me mastit. Kjo tregon për një mungesë të lëndëve ushqyese, në mënyrë specifike për një deficit të proteinave. Këto mungesa mund të jenë për shkak të konsumit të ulët të ushqimit (sëmundje yndyrore të mëlçisë). Përveç kësaj vetëm pak para kohës së pjelljes, kërkuesit kanë vërejtur në plazmën e gjakut të lopëve të shëndetshme përqëndrime më të larta të tokoferolit (Vit. E), albuminës dhe retinolit. Vetëm një javë pas pjelljes te grupi i lopëve të shëndetshme përqëndrimi i haptoglobinës në plazmën e gjakut ishte më i lartë se te lopët me sëmundje të gjirit.

Rekomandimet për furnizimin me mikro dhe makroelementë		
Lëndët ushqyese	Lopët në laktacion	Lopët në tharje
Kalcium (g)	5,8-6,2	4,5-150
Fosfor (g)	3,6-4,2	3,5

Magnez (g)	1,5-2,0	1,5-3,0
Natrium (g)	1,5-2,0	1,2-1,5
Sqfufur (g)	1,8-2,0	1,5-2,0
Kalium (g)	<15	<15
Mangan (g)	50	50
Zink (mg)	50	50
Bakër (mg)	10	10
Selen (mg)	0,2	0,2
Jod (mg)	0,5	0,5
Kobalt (mg)	0,2	0,2

Vitaminat forcojnë sistemin imunitar

Eksperimenti tregoi se furnizimi i duhur me vitamina forcon sistemin imunitar. Proteinat të tilla si albumina dhe globulina (proteinat retinol) sigurojnë që vitaminat të hyjnë në qarkullimin e gjakut dhe aty ku janë të nevojshme. (Prandaj është e rëndësishme, që lopët në fillim të laktacionit të jenë të mirë-furnizuara me proteina.

Vitaminat e nevojshme për kafshë dhe ditë			
Vitaminat	Periudha në tharje	Periudha e parë e laktacionit	Pjesa e mbetur nga laktacioni
A (IE)	75.000	130.000	100.000
D3 (IE)	25.000	40.000	40.000
E (mg)	500-(1.000)	1.000	500

Çfarë rëndësie kanë këto kërkime në praktikë?

Këto kërkime treguan se nevoja për ushqim e lopëve të qumështit luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në shëndetin e gjirit, por edhe në metabolizëm. Të dyja janë të varura nga njëra-tjetra. Nëse lopa nuk merr mjaftueshëm ushqim voluminoz, atëherë ajo ka një deficit në energji. Përgatitja e racionit ushqimor me përbërje të pakët strukturore dhe me mbingarkesë të amidonit dhe laktozës sjell probleme të pashmangshme gjatë fermentimit në rumen. Ky racion ka një efekt negativ në sistemin imunitar të lopës dhe gjithashtu mund të çojë në infeksione të shkaktuara nga bakteret. Për këtë konsulentët ushqimor u rekomandojnë fermerëve, që t'i kushtojnë rëndësi sasisë së lartë të ushqimit voluminoz. Gjatë periudhës së tharjes çdo lopë duhet që të marrë një sasi prej 10 kg lëndë të thatë në ditë, ndërsa lopët në laktacion duhet të marrin minimumi 12 kg lëndë të thatë. E rëndësishme është që të përdoret silazhi, kashta dhe sana. Ngarkesat me mykotoksinë dhe endotoksinë në ushqim sjellin një rritje të numrit të qelizave.

Ushqimi duhet të ketë strukturë

Në thelb, racioni i lopëve duhet të ketë në çdo kohë një strukturë, me qëllim që rumeni të punojë mirë. Një fermentim i mirë në rumen është veçanërisht i rëndësishëm në periudhën afër-lindjes. Duhet të paktën 2,6 kg fibër e strukturuar ose 2,8 kg fibër (celulozë dhe lingnin) për një kafshë në ditë. Nëse në racion përziejme kashtë, ajo

duhet të jetë e copëtuar, e shkurtër dhe pa myk. Gjithashtu sasia e lartë e glukozës dhe amidonit ndikon negativisht në metabolizëm.

Prandaj rekomandimi është, që përmbajtja e amidonit dhe glukozës në racion të jetë në total jo më shumë se 280 g/kg. Për këtë mund të kemi jo më shumë se 60g sheqer. Shuma e përgjithshme e amidonit që merr një kafshë në ditë, nuk duhet të kalojë 6.000 g. Mbi racionet e grurit, kufijtë e caktuar që duhen respektuar janë: Nëse përdoret vetëm 1 lloj drithëri, nuk duhet të jepet më shumë se 4 kg për kafshë në ditë. Dy lloje drithërash të tilla si gruri dhe elbi, sasia maksimale është 6 kg për kafshë në ditë. Racioni i lopëve në tharje duhet të përmbajë më pak amidon dhe glukozë. Në fazën e parë, duhet të kemi vetëm një maksimum prej 150 g/kg dhe në javët e fundit para pjelljes, mund të rritet përmbajtja e glukozës dhe amidonit në 150-180 g/kg.

Ushqyerja e saktë me minerale

Të ushqyerit me minerale, vitamina dhe mikroelementë të lopëve në tharje ka një rëndësi të madhe, pasi ajo merr/ ka rezerva të mjaftueshme gjatë gjysmës të laktacionit të parë. Për një praktikë bujqësore kjo do të thotë se lopët në tharje duhet të trajtohen me ushqime të pasura me minerale. Gjatë laktacionit raporti i kalciumit dhe fosforit është gati 2:1, sepse lopët në tharje duhet të ushqehen me ushqim të varfër me kalcium. Lopëve duhet tu sigurohet në mënyrë të barabartë elementët si kalcium, fosfor, magnez, natrium dhe squfur si dhe me mikroelementët mangan, zink, bakër, selen, jod dhe kobalt. Rekomandimet mbi të ushqyerit e lopëve në tharje dhe atyre në laktacion janë të përmbledhura në tabelën “Rekomandimet per furnizimin me mikro dhe makroelemente”.

Përveç mikroelementëve edhe vitaminat janë të rëndësishme për metabolizmin dhe sistemin imunitar. Mungesa e vitaminës D3 ndikon në përthithjen e fosforit dhe kalciumit nga metabolizmi dhe në mënyrë të tërthortë dhe në mënyrë të tërthortë ndikon edhe në pjellori.

Vitamina B karotina (një mbinivel i vitaminës A) ka një lidhje direkte në aftësinë riprodhuese, e cila nxit steriosintezën, që stimulon folikulat dhe trupat e verdhë. Kryerja e analizave të gjakut te kafshët në fund të laktacionit si dhe në fund të ditës së 60 të laktacionit, na tregojnë nëse duhet dhënë Vitamina B karotina apo jo. Plotësimi i racionit me 300 deri në 500 mg β Karotin duhet të bëhet nëse në gjak ka mangësi. Vitamina E është për lopët me një peshë të madhe trupore – si për pjellorinë ashtu edhe për mbrojtjen e qelizave dhe sistemin mbrojtës. Sasia e nevojshme e vitaminave A, D dhe E në ushqim janë listuar në tabelën “Vitaminat e nevojshme për kafshë”.

Ndalimi i gabimeve të menaxhimit të stallës

Gabimet në të ushqyer si dhe mangësitë në procesin e mirëmbajtjes, si mbipopullimi, zhurma, ajri i papastër, dhimbja sjellin një stres oksidativ te lopët. Kjo ndodh, sepse

rigjeneron radikalet e lira, që ndikojnë negativisht në sistemin imunitar, në metabolizmin e lopës dhe në rritjen e numrit të qelizave somatike. Ulja e kushteve të mirëmbajtjes dhe ushqyerja jo e duhur, do të sjellë si pasojë infeksione të reja të ashtuquajtura mastit. Studime të ndryshme tregojnë, se vetëm kafshët, që jetojnë në një mjedis pa stres dhe me mbrojtje të mirë të fizikut të tyre kanë shkallë optimale shëruese pas aplikimit të trajtimit me antibiotik. Trajtimi me antibiotik nuk thotë nga ana tjetër kjo terapi, duhet që të mbizotërojë dhe të zhduk gabimet në menaxhimin e stallës.